



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Mbledhja nr. 145/2024

Prishtinë, më 8.10.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Driton Hyseni, Gramoz Agusholli, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Munguan: Abelard Tahiri, anëtar.

Të ftuar: Liza Marku, Ajrina Gashi- Hamdiu, Sead Mujovi dhe Evetar Zeqiri, drejtorë të bordit në NP “KOSTT”.

Pjesëmarrës tjerë: Mimoza Byqmeti, Taulant Temushaj, Shaban Neziri dhe Nebih Hani, KOSTT; Festim Bytyçi, GP AAK, Fjollë Haziri, KDI, Bedri Baliu, Salih Hoxha dhe Sami Gashi, GP LVV; Doruntina Murturi, Kuvend dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 1.10.2024 – II - ;**
- 3. Formimi i panelit për zhvillimin e procesit të intervistimit për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit”;**
- 4. Vazhdimi i shqyrtimit të raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a. për vitin 2023;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 1.10.2024-II-;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur me datë 1.10.2024 – II-, u miratua pa vërejtje.

3. Formimi i panelit për zhvillimin e procesit të intervistimit për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit”

Kryetari, tha se dje është mbyllur konkursi që e kemi rishpallur për “Kryesues të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU”. Ligji e ka paraparë që Komisioni e kryen procesin përzgjedhës, por tani të vendosim se a do të jemi në panel tërë Komisioni apo do të caktojmë një panel në përbërje të gjithë grupeve parlamentare, etnike dhe gjinore. Një këshillë paraprake është se deputeti apo anëtari i panelit duhet të jetë i përfshirë në tërë procesin e intervistimit. Ndonjë deputet që s’ka interes të jetë në panel, lirisht lë ta njoftojë komisionin sot, se nuk do të jetë në panel. Paneli, pas përfundimit të procesit të intervistimit, do të hartojë raportin dhe do ta paraqesë para komisionit për miratim.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

V E N D I M

- 1. Komisioni, në përbërje të plotë, e përben panelin për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU”;*
- 2. Paneli kryen procesin e intervistimit të kandidatëve dhe i paraqet komisionit raport me shkrim;*
- 3. Deputeti, i cili mungon në takimin e parë të panelit, nuk mund të vazhdojë tutje procesin e intervistimit, si dhe deputeti që gjatë procesit tërhiqet nga paneli, konsiderohet sikur të mos kishte marrë pjesë fare në këtë proces.*
- 4. Shpenzimet e krijuara nga aktiviteti i këtij grupi mbulohen nga buxheti i komisionit.*

4. Vazhdimi i shqyrtimit të raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a. për vitin 2023

Kryetari, tha se Komisioni e ka filluar shqyrtimin e këtij raporti, më datë 5 korrik 2024, ndërsa sot po vazhdojmë raportimin, aty ku kemi mbetur. Ai fillimisht kërkoi nga deputetët, që të mos përsëriten pyetjet e njëjta nga mbledhja e kaluar, kurse iu shtroi pyetje anëtareve të bordit në lidhje me disa ankesa për ndërhyrje nga kryeshefi në procedurat e prokurimit në përcaktimin e kritereve.

Liza Marku, drejtore e Bordit dhe kryesuese e Komitetit të Auditimit në KOSTT, tha se në një të njëjten nga mbledhjet e bordit, janë adresuar shqetësime në lidhje me procedurat e prokurimit rreth transformatorit të Fushë-Kosovës. Pas ngritjes se këtyre shqetësimeve, ajo tha se kam

kërkuar një raport për këtë lëndë. Raporti i detajuar është përgatitur nga kryeshefi dhe është prezantuar në bord. Kemi shqyrtuar mundësinë edhe të një auditimi special për këtë lëndë, por meqenëse lënda është në proces, nuk mund të bëhet auditim special për një lëndë e cila është ende e papërfunduar.

Kryetari, tha se në bazë të raporteve, vërehet se shkalla e realizimit të investimeve është 47%. Pyeti: Cili është komenti i juaj për këtë shkallë të ulët të realizimit?

Liza Marku, KOSTT, tha se jemi të vetëdijshëm për shkallë relativisht të ulët të realizimit, por duhet të kemi parasysh se viti 2023 ka qenë i karakterizuar me krizë të thellë financiare dhe kjo ka ndikuar në mosrealizim të projekteve në shkallë më të lartë.

Kryetari pyeti: A keni vërejtur lëvizjet e kuadrit të brendshëm dhe punësimet gjatë kësaj faze, cili është komenti i juaj dhe çka keni ndërmarrë, si bord, nga lëvizjes së kuadrit dhe strukturës organizative të KOSTT-it? Në lidhje me këtë, kemi pranuar shkresa zyrtare nga stafi i brendshëm i KOSTT-it.

Liza Marku, KOSTT, tha se për këto lëvizje, jemi siguruar që kur të bëhet plani i auditimit për vitin 2023, që auditori t'i analizojë të gjitha këto lëvizje dhe kemi pasur kërkesë specifike ndaj auditorit që këto lëvizje të shikohen se a janë respektuar të gjitha ligjet në fuqi përgjatë kohës që janë bërë këto lëvizje të stafit të brendshëm. Kemi raportin e auditorit të brendshëm për burimet njerëzore të vitit 2023, dhe sipas këtij raporti, janë respektuar të gjitha procedurat e nevojshme. Ajo tha se jemi të shqetësuar dhe kemi dhënë vërejtje te kryeshefi Ekzekutiv, për faktin se kemi shumë pozita që drejtohen nga ushtrues detyre.

Kryetari pyeti znj. Ajrina Gashin, në lidhje me një shkresë të dërguar Komisionit Parlamentar. ai tha se në atë shkresë ka shumë informata dhe të dhëna. Përveç informatave, ju si anëtare e bordit, çka keni ndërmarrë ndaj këtyre shqetësimeve?

Ajrina Gashi- Hamdiu, drejtore e Bordit të KOSTT-it, tha se pas raportimit të kaluar në këtë komision, kam paraqitur pretendimet e mia për disa shkelje ligjore. Të njëjtat pretendime i kam dërguar edhe në Prokurorinë Speciale të Kosovës. Ajo tha se më datë 24.11.2023, kemi pasur mbledhjen e bordit dhe njëri nga anëtarët e bordit, në atë mbledhje, është interesuar të dijë rreth zhvillimeve të transformatorit të Fushë-Kosovës. Ajo tha se nuk kemi i pranuar informata, sepse na është thënë se jemi në proces dhe aty ka mbetur. Në fakt, po atë ditë, veçse është kryer procesi i transformatorit dhe është anuluar tenderi. Kurse, më datë 11.12.2023, njëri nga koleget tonë ka dërguar një email dhe ka kërkuar sqarime rreth mbylljes së këtij tenderi. Aty e kemi kuptuar se është anuluar ky projekt. Në njërin nga mbledhjet e vitit 2024, kur kemi diskutuar, njëri nga anëtarët e bordit ka kërkuar të mos diskutojmë për këto raste, sepse ky është nën hetime dhe mund të ndikojmë në prishje të hetimeve. Më pas, kemi pranuar raport nga zyrtarja përgjegjëse e prokurimit, që mes të tjerash, potencohet se ka pasur ndërhyrje nga kryeshefi, ku një kriter është caktuar me urdhër të kryeshefit. Për këto arsye kam dërguar këtë shkresë te ju dhe tek organet kompetente, sepse unë kam nënshkruar një deklaratë nën betim, në lidhje me mbrojtjen e institucionit dhe besimit që me është dhënë.

Liza Marku, KOSTT, tha se në cilësinë e anëtares së bordit të ndërmarrjes, nuk kam pasur asnjëherë informatë që tenderi është anuluar. Për informatën tuaj, kontrata për transformatorin e Fushë-Kosovës, edhe pse ka pasur ngecje dhe vonesa, kontrata për transformatorin pritet të përfundojë në fillim të vitit 2025. Po ashtu, ajo tha se nga auditori i brendshme kurrë nuk jemi njoftuar se rasti është dërguar në organet hetuese, sepse nuk e ka pasur këtë informatë.

Ajrina Gashi – Hamdiu, KOSTT, tha se më datë 14.12.2023, kemi pranuar një email, në të cilin kemi qenë në CC, ku janë dërguar të gjitha dokumentet dhe këtu kemi kuptuar se është anuluar tenderi i transformatorit të Fushë-Kosovës.

Liza Marku, KOSTT, tha se kushdo që ka pasur tendencë të përzierjes në procesin e tenderimit, përgjegjësia është mbi secilin dhe ndaj auditorit të brendshëm do të duhet të kërkohet auditim, me theks të veçantë, në këtë rast.

Evetar Zeqiri, kryeshef Ekzekutiv në KOSTT (njëkohësisht drejtor bordi), tha se në lidhje me shkallën e realizimit prej 47% të investimeve, edhe përkundër krizës së madhe energjetike që ka karakterizuar sektorin e energjisë përgjatë vitit 2023, kemi përqindjen më të madhe të realizimit në historinë e KOSTT-it. Po ashtu, krahasuar me % e TSO-ve evropiane, është 18%. Ai tha se aktualisht kemi 4 projekte të mëdha në proces, siç është projekti i Ferizajt, Fushë-Kosovës, Malishevës dhe projekti që u dogj nënstationi. Ai tha se aktualisht kemi probleme me procese gjyqësore. Projekti i Ferizajt është dërguar dy herë në gjykatë. Herën e parë e kemi fituar rastin në Gjykatën Themelore, kemi ndërtuar 10 shtylla dhe ndaj dy shtyllave, gjykata ka vendosur masë sigurie dhe nuk mund të vazhdojmë punën, përderisa jemi në këtë situatë. Fushë-Kosova, është tenderuar në prill të vitit 2024, ekzistojnë shumë koncepte në prokurim dhe deri në momentin kur të nënshkruhet kontrata, nuk mund të thuhet se tenderi është anuluar. Rasti i transformatorit të Fushë-Kosovës asnjëherë nuk është anuluar. Ai tha se në cilësinë e kryeshefit, nuk jam përzier e as nuk do të përzihem asnjëherë në punët të cilat nuk janë kompetencë e imja, por ai tha se në cilësinë e kryeshefit jam përgjegjës për aprovimin e kritereve të propozuara nga prokurimi dhe ata nuk marrin përgjegjësi për parametrat e nënstationit dhe aprovimi im është i bazuar në ligj, dhe unë vetëm kam ushtruar funksionin tim, asnjëherë nuk i kam dhënë urdhër askujt, mirëpo unë kërkohet përgjegjësi nga vartësit e mi. Ai tha se kompania e njëjtë që ka qenë edhe më herët, e ka fituar kontratën.

Kryetari pyeti: Kush është kjo kompani?

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha se është kompania “Ballkan Petrol”.

Kryetari pyeti: A jeni takuar me përfaqësues të “Ballkan Petrol”, gjatë procesit të përzgjedhjes të kësaj kompanie?

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha se e njëjta kompani ka edhe kontrata të tjera dhe unë kur kam nevojë që të takoj përfaqësues të kompanive, i ftoj në ambientet tona të punës dhe për këto takime janë edhe minutat e takimeve. Ai tha se përgjatë fazës së përzgjedhjes nuk jam takuar me përfaqësues të kësaj kompanie.

Kryetari kërkoi të dërgohen në formë të shkruar, minutat e takimeve me përfaqësuesit e kompanisë “Ballkan Petrol”, gjatë dhe pas procesit të përzgjedhjes së transformatorit të Fushë-Kosovës. Ai pyeti: Sa këshilltarë juridikë keni të angazhuar, cila është kompania që e keni angazhuar për këshillim juridik dhe a keni humbur ndonjë lëndë dhe sa është shuma e humbjeve në raport me operatorët privatë?

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha se kemi zyrën ligjore, e cila përbehet prej menaxherit dhe 4 specialistëve juridikë. Gjatë vitit 2023, kemi angazhuar një kompani. Për çështje komerciale të mëdha kemi vlerësuar se duhet të marrim konsulencë të jashtëm, për të na përfaqësuar në raste më të komplikuara. Në një proces tenderimi publik kemi angazhuar kompaninë “Koci & Vokshi”, vlera e kontratës ka qenë 30.000 euro, kurse shpenzime janë bërë 20.000 euro. Pra, 20.0000 euro, për një vit, i kemi shpenzuar për çështje të ndryshme përfaqësimi.

Kryetari kërkoi informatë zyrtare të shkruar, në lidhje me kompaninë këshilluese për relacionin e KOSTT-t me Matkos dhe për shumën e humbjeve financiare të KOSTT-it. Po ashtu, kërkoi një opinion nga anëtari i Bordit të KOSTT-it, z. Sead Mujovi, në lidhje me problematikat në KOSTT.

Sead Mujovi, drejtor i Bordit në KOSTT, tha se shumica e komenteve janë përfshirë edhe nga kolegët e mi. Ai tha se ne i kemi paraqitur të gjitha shqetësimet, të cilat i keni edhe në procesverbale. Në lidhje me shkallen e ulët të realizimit, uroj që në vitet tjera, të jetë më e lartë shkalla e realizimit.

Evetar Zeqiri KOSTT, tha se në vitin 2023, kemi pasur 4 auditime, një auditim të brendshëm të burimeve njerëzore, kemi pasur dy auditime prej “Grand Tortonit”, një auditim nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe kemi pasur një inspektim të plotë të të gjitha rekrutimeve nga Inspektorati i Punës. Për të gjitha këto, gjetjet në burime njerëzore janë zero.

Kryetari pyeti: Sa ushtrues detyre i ke në ndërmarrje?

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha 4 ose 5, saktësisht do ta dërgoj si informatë të shkruar. Ai tha se janë bërë 60 rekrutime, prej se kam marr detyrën.

Ajrina Gashi- Hamdiu, KOSTT, tha se dua të theksoj se në lidhje me rastin e Matkos, kemi kuptuar se Matkos na ka çuar në procesin e përmbarimit dhe javën e kaluar janë përmbaruar mbi 250.000 euro dhe ne duhet të marrim masa edhe ndaj institucioneve tjera, sepse po dëmtohet KOSTT.

Armend Muja: Cilat janë institucionet tjera?

Ajrina Gashi- Hamdiu, KOSTT, tha se janë ZRRE, KEDS, sepse në vitin 2022, janë informuar ata dhe në fillim të vitit 2023, z. Zeqiri e ka informuar KEDS-in për shkyçje, mirëpo deri në nëntor, kur e kemi pranuar përgjigjen, pra pas 1 viti e gjysmë, nuk kemi pasur informatën e saktë se a kemi rrjedhje të energjisë apo jo.

Armend Muja- Mesa kam kuptuar, kanë qenë dy operatorë të ndryshëm dhe KOSTT-i ka paguar një Matkos tjetër dhe këtë me të cilin ka pasur raporte, apo jo?

Ajrina Gashi- Hamdiu, KOSTT, tha se Matkos ka hapur një kompani të re, me emër të ngjashëm paralelisht. Ajo tha se njëra kompani quhet “Matkos Group” dhe tjetra “Matkos Group HC Sharrri”. Me “HC Sharrri”, ne nuk kemi marrëveshje. Në bazë të raporteve, ai ka dërguar faturat, nuk janë paguar faturat prej KOSTT-it për HC Sharrin, por janë bërë për “Matkos Group”. KOSTT-i e ka informuar gjithmonë palën, se ne nuk mund t’i pranojmë këto fatura, sepse nuk kemi marrëveshje me HC Sharrin.

Armend Muja, tha se i bashkëngjitëm kërkesës së kryetarit, për t’i dërguar të gjitha materialet që lidhen me Matkos.

Driton Hyseni, kërkoi nga znj. Ajrina Gashi sqarim, se me çfarë date iu keni drejtuar prokurorisë dhe kur e keni kuptuar se duhet drejtuar prokurorisë, dhe a e ke bërë këtë veprim para se të njoftoni komisionin apo e keni dërguar lëndën në Prokurori pa e njoftuar paraprakisht edhe Komisionin përkatës Parlamentar?

Ajrina Gashi -Hamdiu, KOSTT, tha se në mbledhjen e kaluar, kur kemi raportuar në komision, kam paralajmëruar dhe ju kam njoftuar, se do t’iu drejtohem edhe juve, si komision, me një shkresë, por të njëjtën, kam njoftuar se do ta dërgoj edhe në prokurori. Më datë 5.7.2024, kam qenë në raportim në komisionin tuaj dhe më datë 10.7.2024 i kam dërguar te ju dhe pastaj edhe në prokurori, këto materiale.

Driton Hyseni, kërkoi sqarime rreth çështjes se emërimeve në KOSTT, vendosjes në mënyrë jo meritore, pozita të cilat janë dhëne pa kaluar në procese rekrutuese. Pyeti: Pse nuk arritët ta bëni riorganizimin dhe tani jemi në një situatë ku është angazhuar një kompani e jashtme, të një procesi të ristrukturimit të ndërmarrjes, nuk e dimë sa do të kushtojë dhe kur do të kryhet ky proces? Është dashur të shfrytëzohen kapacitete e brendshme për të kryer këtë proces.

Evetar Zeqiri KOSTT, tha se ndër punët e para që kam tentuar të bëj, ka qenë çështja e ristrukturimit, ka qenë propozim i imi të angazhohet ndonjë kompani ndërkombëtare, e cila ka përvojë në këtë fushë, sepse ristrukturimet e brendshme nuk kanë funksionuar asnjëherë. Kontrata e nënshkruar për ristrukturim të ndërmarrjes është 150.000 euro.

Armend Muja, lidhur me këtë kontratë, kërkoi rezonimin, kush e ka aprovuar, kur është bërë propozimi, pse është tejkualuar plani i prokurimit, çka është ndryshe nga studimi i vitit 2021 i një organizate belge dhe çka është kjo ideja e konsulencave? Më duhet një arsyetim edhe nga bordi për këtë dhe këto informata të përcillen me shkrim. Shoh një tendencë të rrezikshme të shpenzimit të mjeteve për konsulencë nga ana e kryeshefit, nuk ke të drejtë të shpenzosh paratë ashtu sikur të ishin tuajat. Unë, si deputet, nuk aprovoj të tilla qasje dhe nuk aprovoj raporte të tilla.

Driton Hyseni, kërkoi sqarim rreth afatit të përfundimit të punës së kësaj kompanie.

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha se faza e përgatitjes se raportit është 6 muaj. Ai tha se asnjë ristrukturim nuk kryhet shpejt.

Kryetari pyeti: A kemi ndonjë vendim që e ka vlerësuar kompaninë tjetër më të vjetër si jofunksionale, joefektive, qoftë edhe nga ish- menaxhmenti, që të konstatojë se studimi i TSO-së belge nuk mund të implementohet që pastaj të kalohet në lidhje të kontratës me një kompani tjetër?

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha me sa kam informacione, ka qenë donacion nga TSO belge dhe arsyeja se pse nuk është aprovuar nga bordi, nuk kam informacione. Pra, do të shohim pse nuk është bërë dhe i takon vitit 2018, tani jemi në vitin 2024 dhe nuk e di a është relevante me kohën tani ai studim.

Armend Muja, tha se kërkoj llogari nga bordi për këtë.

Liza Marku, KOSTT, tha se mund të konfirmoj se nga të gjithë anëtarët e bordit, njëzëri, është aprovuar linja buxhetore për ristrukturim të ndërmarrjes, është përmendur që është një vlerësim dhe nuk është servuar si dokument fillestar, por është paraqitur më vonë. Ne jemi njoftuar dje për këtë prokurim dhe nuk ka tejkallim të linjës buxhetore, sa i përket kësaj.

Armend Muja, tha se keni pasur edhe konsulent për ISO standarde, konkretisht për ISO të riskut. Pyeti: A mund të më thoni më shumë?

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha se KOSTT është e vetmja ndërmarrje publike, e cila është e certifikuar me disa ISO standarde. ISO e riskut, që ju po e përmendeni, ne nuk jemi të certifikuar për të. Ne po synojmë ta bëjmë komitetin e riskut, zyrtarin e riskut dhe kjo është në proceset në vazhdim.

Driton Hyseni, kërkoi informacione rreth investimeve kapitale, se kur mund të marrim shërbime nga këto investime.

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha se nënstacioni i Ferizajt, 97% e punëve janë kryer. Linja ende nuk është përfunduar, sepse është me masë të përkohshme të gjykatës. Në momentin që largohet masa e sigurisë, brenda dy muajsh, do të përfundohet puna.

Kryetari, tha se kur është interesi publik, nëse ka planifikim të mirë, nuk mund të pengoj procesin gjyqësor, sepse është në interes publik, duhet ta pranoni se këto probleme janë për shkak të mungesës së koordinimit dhe mungesës së planifikimit adekuat.

Jeta Statovci, pyeti rreth ristrukturimit dhe avancimeve në pozita të caktuara në shpërfillje të procedurave. Kemi kërkuar të veprohet nga ana e menaxhmentit dhe Bordit të KOSTT, cilët janë hapat e marrë, në këtë drejtim?

Liza Marku, KOSTT, tha se ky është problem më i vjetër, para se të vijmë ne. Procedurat e brendshme për rekrutim nuk kanë qenë në linjë me udhëzimin administrativ. Nëse do të ndërmerrnim hapa të rikthimit, do të rrezikonim humbjen e rasteve, sepse procedurat e

brendshme ia kanë lejuar ekzekutivit, që pa konkurrueshmëri, të bëhen avancime. Pra, procedurat e brendshme nuk kanë qenë në linje me udhëzimin administrativ të rekrutimit dha ia kanë lejuar menaxhmetit avancimet.

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha se nga tetori i vitit 2022, të gjitha procedurat burimeve njerëzore në KOSTT bëhen përmes konkurseve. Për 4 pozita ka pasur auditim të veçantë dhe është rekomanduar dërgimi në organet hetuese dhe të njëjtat i kam denoncuar në organet e caktuara hetuese.

Ajrina Gashi – Hamdiu, KOSTT, tha e auditimi për këto 4 pozita. ZKA, në auditim të performancës, nuk i ka futur, këto janë gjetje nga auditori i brendshëm dhe janë dërguar në organet hetuese.

Jeta Statovci, tha se së fundi kemi lajme të uljes së konsumit në veri të vendit dhe çështja e vazhdimit të marrëveshjes me ENTSO-I.

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha se futja e kompanisë “Elektroserver” në sistem, është një veprim që ka ndikuar në ulje të konsumimit në veri të vendit. Kjo kompani kryen të gjitha obligimet e veta në KOSTT. Sa i përket bashkimit të tregjeve, jemi ndër vendet e para të Ballkanit, që e kemi bërë bashkimin e tregjeve, kemi nënshkruar marrëveshje me bashkimin e tregjeve me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë.

Pal Lekaj, tha se nga ky raportim ne duhet të ballafaqohemi me sfidat dhe problemet që e përcjellin këtë sektor. U përmend prokurimi publik, ristrukturimi, ndërtimi i transformatorëve dhe ajo që me bie në sy, është se bordi dhe kryeshefi ekzekutiv duhet të kenë një ndarje nga prokurimi publik. Nëse keni interferuar në prokurim publik, ju keni bërë shkelje ligjore dhe për këtë janë organet kompetente që duhet të merren me këto çështje. Ristrukturimi i ndërmarrjes dhe angazhimi i konsulencave, kjo është punë e ndërmarrjes dhe duhet të zgjidhet me resurset njerëzore të brendshme, pa shpenzuar mjete për konsulencë, janë standardet e caktuara për ristrukturim dhe s’ka nevojë për shpenzime në këtë drejtim. Doracaku i riskut nuk është ndonjë shpikje që kërkon angazhim të madh. Pra, do të duhej të hartohet nga stafi dhe të dihen pikat e riskut. Në lidhje me pozicionet e larta që drejtohen me ushtrues detyre brenda ndërmarrjes, duhet të keni shumë kujdes, që të mos bëhen shkelje ligjore dhe të mos lihen këto pozita të paplotësuara.

Liza Marku, KOSTT, tha se shqetësimet e juaja janë edhe shqetësime tona dhe qëndrimet e bordit janë në linje me qëndrimet tuaja. Shembull, në lidhje me procesin e prokurimit, dhe jemi munduar të tërheqim vërejtje në lidhje me kërkesat e individëve të caktuar, të cilët kanë kërkuar dosje të caktuara të prokurimit dhe secili që ka bërë shkelje, në këtë drejtim, do të përgjigjet para ligjit. Në lidhje me kapacitetet e burimeve njerëzore, që të merren me ristrukturim, bordi ka vlerësuar unanimisht që është e nevojshme që ristrukturimi të bëhet përmes konsulencës dhe tani është përgjegjësi e ekzekutivit për ekzekutim të duhur të angazhimit të kompanisë së duhur për ristrukturim.

Valentina Bunjaku - Rexhepi, tha se shumë lëvdata kishit për vete, por shohim se në anën tjetër përmbaruesi ju ka ekzekutuar mjete. Në lidhje me “Elektroserverin”, sa mjete keni shpenzuar që ta merrni licencën e “Elektroserverit”?

Evetar Zeqiri, KOSTT, tha se në lidhje me përmbarimin, përmbaruesi ka marrë mjetet në procedurë përmbarimore dhe jo në procedurë gjyqësore. Procesi meritator i bie të shterohet në proces gjyqësor. Nuk paguajmë mjete për licencë të “Elektroserverit” dhe asnjë operatori tjetër.

Armend Muja, tha se shohim se keni rekrutuar shumë konsulentë, në lidhje me projekte të ndryshme, a keni diçka që dini të bëni vetë, pa angazhuar konsulentë? Për 3 vite, kemi rrëfime të njëjta dhe angazhim të konsultë pas konsulentëve. Nuk do të duhej të jetë fokusi vetëm në angazhim të konsulentëve, ju jeni ndër ndërmarrjet e vogla për nga numri i stafit, që të angazhoni kaq shumë konsulentë. Kjo i bie që keni mungesë përvoje dhe mungesë të aftësive menaxheriale.

Liza Marku, KOSTT, tha se në lidhje me angazhimin e kompanisë ligjore, KOSTT ka shumë lëndë dhe kemi konstatuar se nuk kemi kapacitete të brendshme që t’i mbulojmë çështjet legale me kapacitete të brendshme. Kurse, me konsulentat tjera, kryeshefi, në bazë të kompetencave të tij, ka vendosur dhe mund të përgjigjet për këto angazhime.

Armend Muja, kërkoi informacione shtesë, me shkrim, në lidhje me kontratat për konsulencë, numrin e pozitive të sakta. Ai kërkoi informacione rreth kontratës për sigurim shëndetësor aksidental. Pyeti: Pse do të duhej të keni kontratë shtesë me “Rezonancën”, në vlerë prej 50.000 euro për kontrolle të ndryshme, kur këtë e mbulon kontrata për sigurim shëndetësor? Ai kërkoi informacione edhe për pajisjet e “Professional Alarm”. E dini që me vendim të Qeverisë së Kosovës, ndalohet prokurimi i këtyre pajisjeve, për shkak të sigurisë së ulët. A i ka KOSTT-i këto pajisje të instaluara për vëzhgim? Ai kërkoi informacione rreth paraqitjes në media, kryesisht në mediumin “Indeksonline.net”. Shohim storie të porositura në këtë medium, çfarë marrëveshje keni me këtë medium? Për fund, ai kërkoi sqarime rreth një informate që një zyrtar i KOSTT-it ka dhënë komente në lidhje me dështimin e ankandit të energjisë elektrike në Uashington, si dhe kërkoi informacione rreth avarive në Trepçë. -A është e drejtë “Trepça” të ketë nënstacion të vetin?

Kryetari, tha se mbështet kërkesat e deputetit Muja dhe presim që të përgjigjeni me shkrim.

Për shkak të mungesës së kuorumit, vendimmarrja shtyhet në një tërësi nga mbledhjet e radhës.

5. Të ndryshme Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit